



E-Pjesmarrje

Merr pjesë në marrjene vendimeve duke përdorur shërbimet e TI



Ngjarjet e ardhshme në WEB.DEP

- **Java e 2^{te} e Prill 2008**
Workshop Kombëtar në Shqipëri
- **Java e 2^{te} e Maj 2008**
Workshop Kombëtar në Serbi
- **Java e 1^{te} e Qershor 2008**
Workshop Kombëtar në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë
- **Java e 1^{te} e Dhjetor 2008**
WEB.DEP Konferenca në Greqi

"Nuk është vetëm leximi i lajmeve. Ky është dialogu publik për krijimin e lajmeve të së ardhmes!"

WEB.DEP një shikim i shpejtë

Projekti WEB.DEP ofron një afrim ndërkufitar për vendosjen e një rrjeti informimi e menaxhimi për Ballkanin Perëndimor, i cili do të mundësohet nga Agjencitë Kombëtare të Lajmeve që bashkëpunojnë. Kjo do të arrihet nëpërmjet vendosjes së një baze të përbashkët dhe të ndërvprueshme, një sistemi të hapur komunikimi të monitoruar nga Komisioni Evropian dhe delegacionet e tij kombëtare, të cilat do të lejojnë çdo organizate civile dhe/apo çdo qytetari të paraqesë propozime të plota, plane apo ide të thjeshta për integrimin demokratik, rindërtimin social, zhvillimin, edukimin dhe kulturën, shëndefin, emigracionin etj. Një çështje kyçe në këtë proces është përfshirja aktive e bashkësive kombëtare të gazetarëve dhe ndërlidhja e agjencive të lajmeve dhe bashkësive të gazetarëve në drejtim të komunikimit Evropian.


Qëllimi kryesor i **WEB-DEP** është të krijojë një rrjet të rëndësishëm për menaxhimin e komunikimit dhe informacionit të drejtuar nga Agjencitë Kombëtare të Lajmeve të shteteve të Ballkanit Perëndimor. Projekti përfshin bërësit e politikave dhe aksionerët nga Ballkani Perëndimor si Organizatat Qeveritare më të rëndësishme (Ministritë), Agjencitë Publike të Lajmeve dhe qytetarët në procesin e e-Demokracisë, i mbështetur në një mjedis të unifikuar, në bazë të një grupi rregullash dhe një kod të përbashkët etike.

Kjo do të realizohet duke arritur objektivat specifike të mëposhtme:

- Krijimi i Rrjetit WEB.DEP : Krijimi i një rrjeti të plotë komunikimi, i cili të përfshijë ministritë më të rëndësishme, agjencitë publike të lajmeve dhe grupet sociale të cilët do të përpunojnë dhe zhvillojnë çështjet kryesore të e-Demokracisë.
- Krijimi i "zonës unike" të komunikimit : Ndërtimi i një zone unike të komunikimit për ndarjen e vizioneve dhe eksperiencave, praktikave dhe aktiviteteve ndërmjet institucioneve qeveritare dhe formuesve të opinionit publik nga njëri shtet në tjetrin.
- Bashkimi i "lojtarëve kryesorë" : si agjencitë publike të lajmeve, organizatat qeveritare më të rëndësishme dhe për më tepër përfshirjen e qytetarëve të Shteteve të Ballkanit Perëndimor.
- Rritja e informimit , duke organizuar ngjarje dhe kanale komunikimi në mënyrë që të forcohet dhe të eksplorohet më tej rrjeti WEB-DEP për një publik kryesisht në Ballkanin Perëndimor e më pas përfundimisht në EU-25, Bullgari, Rumani, Turqi duke ndarë eksperiencat nëpërmjet forumit të WEB-DEP dhe duke krijuar ndërlidhje me iniciativat ekzistuese.
- Rritja e bashkëpunimit në zonat kufitare të Ballkanit Perëndimor nga pikëpamja e thjeshtimit të integritimit gradual në nivel pan-Evropian.



Agjencitë e Lajmeve japin Lajmet dhe nisin procedurat për dialogun publik.



Prezantimi i Projektit në Konferencën eGOV07

Projekti WEB.DEP u prezantua në workshop "e-Pjesëmarrja në Rajonet Evropiane Konvergjuese" i cili u organizua si një aktivitet i Konferencës e-GOV07 në Regensburg. Konferenca eGOV07 u organizua nga Shoqata-eGOV dhe ishte pjesë e Konferencës DEXA 2007 që u zhvillua ndërmjet 3 – 7 Shtator 2007 në qytetin e Regensburgut në Gjermani.

Workshop u organizua nga NTUA dhe NAPIER dhe kishte si qëllim çështjen e nxehhtë si e-Pjesëmarrjen në rajonet Konvergjuese si Ballkani.

Ideja kryesore dhe qëllimi i projektit u prezantuan dhe të gjitha çështjet interesante rreth kufijve, zgjidhjet e mundshme dhe puna e ardhshme e projektit u analizuan. Pjesëmarrësit ishin shumë të interesuar mbi projektin dhe kërkuan

materiale për ndjekjen e mëtejshme të progresit të projektit, duke qenë se e-Pjesëmarrja në rajonet konvergjuese është akoma një çështje shkencore e pazbuluar.

Electronic Participation Systems in the Western Balkans: WEB.DEP

Ella Taylor-Smith, International Teledemocracy Centre, Napier University
and
Sotirios Koussouris, National Technical University of Athens, eGovernment Research Unit



Një Pamje Nga Brenda e Portalit WEB.DEP

Portali WEB.DEP do të konsistojë në dy nënsisteme të mëdha:

- një nënsistem për Menaxhimin e Lajmeve, i mirëmbajtur nga gazetarët që do të postojnë histori të reja të cilat qytetarët mund ti lexojnë, dhe,
- një Ambient Komunikimi në formatin e diskutimit në Blog me e-Votime të Integruara, të cilat do të nisen nga gazetarët, duke u bazuar në artikujt që janë nxjerrë nga lajmet e fundit dhe do të jenë fokusimi i diskutimeve për qytetarët, ekspertët e sektorëve specifike dhe përfaqësuesve të qeverisë.

Temat e Diskutimeve do të mbulojnë të gjitha aspektet e jetës së përditshme të qytetarëve si:

- Arti dhe Kultura
- Ekonomia dhe Biznesi
- Edukimi
- Mjedisi
- Zhvillimi Rajonal
- Shkenca dhe Teknologjia
- Stili i Jetesës
- Të Drejtat e Njeriut
- Çështjet Sociale

Secili shtet i WEB.DEP do të ketë portalin e tij, në gjuhën e vendit dhe do të menaxhohet nga gazetarët e agjencive korresponduese të lajmeve (p.sh ATSH, MIA, TANJUG). Paralelisht një ambient komunikimi Anglisht folës do të jetë gjithashtu i disponueshëm, për ti shërbyer diskutimeve të interesit të përbashkët dhe për të lehtësuar përdoruesit e platformës nga Diaspora.



WEB-DEP mundëson vendosjen e dialogut social direkt ndërmjet qytetarëve dhe, organizatave qeveritare dhe entiteteve të tjera ligjore.

Partnerët e Projektit:

Qendra Teknologjike e Athinës

Universiteti Teknik Kombëtar i Athinës

Bashkimi i Gazetarëve të Maqedonisë
& Gazetave Ditore të Trakësë

Agjencia Telegrafike Shqiptare

Qendra Ndërkombëtare e

Teledemokracisë – Universiteti Napier

Agjencia Maqedonase Informacionit

Agjencia Telegrafike Jugosllavisë Re

E-Mail:

symeri@ata-al.net

Faqe Web :

<http://www.web-dep.eu>



Lajme E-Pjesmarrje

Gjatë Dhjetorit Gazeta Ndërkombëtare e Qeverisjes Elektronike (IJEG) hapi një konkurs për çështjen e veçantë të "Sistemet e ePjesmarrjes dhe Shërbimet në Rajonet Konvergjente" e cila kishte një numër të madh kontribuuesish të cilët ofruan zgjidhje apo shpjeguan vështirësitë që shtrihen në këtë fushë. NTUA kishte një propozim editorial në këtë çështje të veçantë dhe ka si qëllim të sjellë njohuritë e marra nga dokumentet e paraqitura në Projekt.

Për më tepër NTUA ka paraqitur një dokument në lidhje me WEB.DEP në të njëjtën gazetë

4 Forume do të jenë të disponueshëm

- **Forumi ATA**
- **Forumi MIA**
- **Forumi TANJUG**
- **Forumi Qëndror (për diskutimet në Anglisht)**

Rrjeti Elektronik i Qeverisë në Shqipëri – Faza II

GovNet është një projekt i bashkë financuar nga Bashkimi Evropian dhe UNDP Shqipëri dhe i realizuar nga UNDP Shqipëri në bashkëpunim të ngushtë me Këshillin e Ministrave si agjencia kryesore Qeveritare e kooperimit. Ky projekt është vazhdimi i fazës së parë të GovNet. Objektivat specifik të projektit janë:

- zgjerimi i rrjetit që të përfshihen institucione të tjera qeveritare
- krijimi i një Sistemi Intranet për të gjithë Qeverinë
- dhe futja e shërbimit VoIP në institucionet kryesore Qeveritare, trajnimi i stafit të TI të institucioneve që do të shtohen GovNet.

- 1,129 punonjës të Qeverisë Qendrore që përfitojnë nga mbrojtja Kundër Viruseve dhe Kundër Plehrave e sistemit të ri të e-mail.
- 20 menaxherë të TI të trajnuar për funksionimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit
- 72,767 USD të shpenzuara në përmirësimin e infrastrukturës së TI në Ministri
- 4 studime për VoIP, shërbimet Intranet/Internet, Dokumenti i Politikave të Sigurisë i realizuar për Qeverinë

Rezultatet e pritshme të projektit janë:

- 19 vendndodhje qendrore të qeverisë të lidhura me rrjet të shpejtësisë së lartë me fibra optike me gjerësi brezi 100 Mbps
- 3,740 metra Fibra Optike
- Sistemi i e-mail i menaxhuar në qendër për qeverinë qendrore



ATC



NTUA



ESIEMTH



ATA



NAPIER - ITC



MIA



TANJUG